REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL

DREJTORIA E PYJEVE DHE MJEDISIT

PROJEKT – VENDIM

Nr. 69 . **Date** 23 /09 /**2026**

"PËR DHENIEN DHENIEN ME QIRA TË SIPËRFAQES 120 HA NË NGASTRAT ME KOD KADASTRAL KO02 00 010 , 013 , 015 , NË EKONOMINË KULLOSORE "BILISHT" (Për Prodhimin E Energjise Te Rinovueshme Nëpërmjet Paneleve Fotovoltaike)

Ne zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore" (I ndryshuar), neni 8 pika 2, Neni 9 pika 1, nenpikat 1.1 shkronja "b" dhe 1.2 shkronjat "a" dhe "c", nenit 27 pika 5, nenit 54 shkronja "e/1", nenit 55 pikat 3 , nenit 64 shkronja "a" dhe "c".Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqiperisë" (i ndryshuar), Nenit 15,17 te Ligjit 9693 date 19.03.2007 "Per fondin kullosor" (i ndryshuar), VKM Nr. 398 date 13.05.2020 "Per disa Ndryshime ne VKM Nr. 433 datë 08.06.2016 " Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listës së inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të Ish-Komunave/ Bashkive".VKM Nr.467 , datë 31.07.2025"Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave ,livadheve për kullotje ose kositje , për veprimtari shoqërore , shëndetësore , sportive e turistike dhe për prodhimin e energjisë të rinovueshme . Udhëzimi I Ministrit të Mjedisit Nr. 01 datë 09.06.2016 " Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik" dhe në Raportin Tekniko- Ekonomik Nr.1969/1 Prot date 10 .08.2026.

PROPOZOJ:

1. Dhenien e miratimit per dhenien me qira te siperfaqes prej 120 ha ne ngastrat me nr. 10 , 13,15 me kod kadastral KO 02 00 010 , KO 02 00 013 dhe KO 02 00 015 ,pjese e ekonomise kullosore Bilisht.
2. Afati i dhënies për përdorim do të jetë 10 vjet.
3. Bashkengjitur Raporti Tekniko- Ekonomik Nr.1969/1 Prot,datë 10 /08 /2026 i Sektorit të Menaxhimit te Pyjeve dhe Mjedisit.
4. Ngarkohet Kryetari i Bashkise Devoll dhe Drejtoria e Pyjeve dhe Mjedisit per zbatimin e ketij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve në nenin 55 pika 6 të Ligjit Nr. 139/2015 " Për vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar

Konceptoi:Drejtor i Drejtorise te Pyjeve dhe Mjedisit
Edmir Cenolli
Konfirmoi bazen ligjore: Prgj.Sektorit Juridik
Eriksela Avdo

REPUBLIKA E SHQIPËRISË-BASHKIA DEVOLL

KRYETARI I BASHKISE
EDUARD DURO

Adresa: Lagjia Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 5; Tel+35581122288; E-mail: bashkiadevoll@gmail.com;
web:http://bashkiadevoll.gov.al/

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E PYJEVE DHE MJEDISIT

RELACION

Prot 3712 Nr

Bilisht, më 23.09.2026

PËR DHENIEN DHENIEN ME QIRA TË SIPËRFAQES 120 HA NË NGASTRAT ME KOD KADASTRAL KO02 00 010 , 013 , 015 , NË EKONOMINË KULLOSORE "BILISHT"
(*Për Prodhimin E Energjise Te Rinovueshme Nëpërmjet Paneleve Fotovoltaike*)

Lidhur me mundësinë e dhënies në përdorim, me kontratë qiraje, të një sipërfaqeje prej 120 ha, e ndodhur në ngastrat nr. 10, 13 dhe 15, në Ekonominë Kullosore "Bilisht", për zhvillimin e një investimi për prodhimin e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme, nëpërmjet instalimit të paneleve fotovoltaike, paraqiten disa nga përparësitë dhe mangësitë që mund të shoqërojnë këtë investim.

Përparësitë e investimit

- Krijimi i të ardhurave për Bashkinë Devoll, nëpërmjet pagesës së qirasë për përdorimin e sipërfaqes.
- Sjellja e një investimi të ri në territorin e Bashkisë, duke aktivizuar një sipërfaqe të konsiderueshme.
- Prodhimi i energjisë nga burime të rinovueshme, duke kontribuar në diversifikimin e burimeve të energjisë. Bashkia po synon rritjen e rolit të energjisë diellore dhe burimeve të tjera të rinovueshme në miksin energjetik.
- Mundësi për krijimin e vendeve të punës, kryesisht gjatë fazës së ndërtimit, por edhe për mirëmbajtjen dhe administrimin e impiantit.
- Përmirësimi i mundshëm i infrastrukturës, si rrugët e aksesit dhe infrastruktura elektrike e nevojshme për investimin.
- Rritja e aktivitetit ekonomik në zonë, për shkak të shërbimeve dhe punimeve që mund të kërkohen gjatë ndërtimit dhe funksionimit.
- Mundësi për përdorim ekonomik afatgjatë të sipërfaqes, duke gjeneruar të ardhura për Bashkinë gjatë gjithë periudhës së kontratës.
- Investimet fotovoltaike mund të zhvillohen me ndikime të menaxhueshme nëse vendndodhja dhe mënyra e ndërtimit planifikohen siç duhet.

Mangësitë dhe problematikat e mundshme

- Reduktimi i sipërfaqes së disponueshme për kullotje, pasi 120 ha do të përdoren për instalimin e paneleve dhe strukturave të tjera.
- Ndikim në aktivitetin e blegtorisë, veçanërisht për barinjte që mund të përdorin aktualisht këtë sipërfaqe për kullotje.
- Ndryshim i pamjes së territorit, për shkak të vendosjes së një numri të madh panelesh dhe strukturave ndihmëse.
- Ndikim i mundshëm në bimësi, tokë dhe biodiversitet, sidomos gjatë fazës së ndërtimit dhe hapjes së rrugëve të aksesit. Ndikimi varet shumë nga mënyra e projektimit dhe vendosja konkrete e impiantit.
- Nevoja për ndërhyrje në terren, përfshirë rrugë, kabina, linja elektrike dhe struktura të tjera të nevojshme.
- Mundësi për konflikte me përdoruesit aktualë të kullotave, nëse sipërfaqja përdoret nga banorë apo blegtorë të zonës.
- Nevoja për rehabilitimin e sipërfaqes në përfundim të kontratës, duke përfshirë heqjen e pajisjeve dhe strukturave të vendosura.
- Për një sipërfaqe relativisht të madhe si 120 ha, duhet të vlerësohet me kujdes ndikimi i përgjithshëm në territor dhe përdorimet ekzistuese.

Përfundim

Në vlerësimin e përgjithshëm, investimi paraqet mundësi për të krijuar të ardhura për Bashkinë Devoll, për të sjellë investime të reja dhe për të rritur prodhimin e energjisë nga burime të rinovueshme, por njëkohësisht duhet të merren në konsideratë humbja e përkohshme e përdorimit kullosor të sipërfaqes, ndikimi mbi blegtorinë, mjedisin dhe territorin.

Konceptoi:

Prgj.Sektori Menaxhimi Pyjesh dhe Mjedisi

Orgest Cenolli

Pranoi:

Drejtori i Drejtorise

Edmir Cenolli

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E PYJEVE DHE MJEDISIT
SEKTORI I MENAXHIMIT TË PYJEVE DHE MJEDISIT

Nr.2969/1 Prot **Bilisht më,1008/2026**

RAPORT TEKNIK-EKONOMIK

MBI STUDIMIN TEKNIKO EKONOMIK PËR DHËNIE NË PËRDORIM NGA FONDI PYJOR TË SIPËRFAQES NË PRONËSI PUBLIKE TË BASHKISË DEVOLL

(Për prodhimin e energjisë të rinovueshme)

Bazuar në Urdhërin Nr.332 datë 28.07.2026 me Nr.Prot 2969 të Kryetarit të Bashkisë për vlerësimin tekniko-ekonomik të sipërfaqes pyjore/kullosore objekt i dhënies në përdorim, grupi i punës i përbërë nga Prgj.Mnxh Pyjesh dhe Mjedisi : Orgest Cenolli, Specilalist/Ing.Pyjesh dhe Mjedisi ,Denis Xhuri , Antonio Kapshtica ,nga data 29.07.2026 deri në datën 06.07.2026 studiuan kërkesën e subjektit Devoll solar shpk me Nipt M61916021L dhe realizoi verifikimin në terren dhe në regjistrin kadastral të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore objekt i dhënies në përdorim. Mbështetur në të dhënat e regjistrit kadastral pyjor / kullosor rezulton që sipërfaqja e kërkuar është 120 ha , dhe shtrihet në ngastrat 010 , 013, 015 , të cilat bëjnë pjesë në Ekonominë Kullosore " Bilisht " dhe janë në pronësi / administrim të Bashkisë Devoll. Përshkrimi parcelar i sipërfaqes objekt studimi dhe kategoria e përdorimit të saj, pasqyrohet në aneksin 1 të këtij raporti . Nga verifikimi në terren rezulton gjëndja : Nuk ka ndryshime në terren te ngastrave .
Ndërhyrjete e propozuara që pasqyrohen në dokumentacionin e paraqitur nga Shoqëria , Devoll Solar SHPK nuk ndyshojnë kategorinë e përdorimit por jepen në përdorim më afatderi në 10 vjet .

Proçedura që ndiqen për dhënien në përdorim nga fondi kullosor publik janë të mbështetura në V.K.M-në nr 1353, datë 10.10.2008 të ndryshuar, "Për rregullat dhe paraqitjen e kërkesës , mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik . Të ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007, "Për fondin kullosor", (të ndryshuar), Udhëzimin e Ministrisë të Mjedisit nr. 1 datë 09.06.2016 "Për rregullat , proçedurat e kërkimit , të shqyrtimit e të miratimit për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik.".VKM Nr. 467, datë 31.7.2025 "Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje ose kositje, për veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike dhe për prodhimin e energjisë së rinovueshme".

Shtojca Nr 3 "Tarifat për dhënien në përdorim të kullotave dhe livadheve për prodhimin e energjisë së rinovueshme" *Lidhja Nr .1*

Pas miratimit të raportit tekniko-ekonomik dhe akteve të tjera normative si më sipër , shoqëria kryen aktivitetin për sipërfaqen e shpallur , vetëm pas lidhjes së kontratës me **Bashkinë Devoll** dhe likujdimin të tarifës prej **18,789,000 lekë/vit.**

Tarifat e dhënies në përdorim/heqjes nga fondi pyjor kullosor bazohen në VKM Nr. 467, datë 31.7.2025 "Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje ose kositje, për veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike dhe për prodhimin e energjisë së rinovueshme

a) Vlerën e përdorimit e sipërfaqes lek/ha/vit 18,720,000lekë.

Trungishte _____ha x_____ _ lek = _____ lekë.
Cungishte ha x lek= lekë.
Shkure ha x _____ lek = _____ lekë.
Kullotë 120 ha x 156,000 lek = 18,720,000 lekë
Inproduktive etj __ha x_____ lek = _____lekë.

b) Vlera e përdorimit për linjat gjatësore në km/vit lekë.

Trungishte	km x	lekë =	lekë.
Cungishte	km x	lekë =	lekë.
Shkure	km x	lekë =	lekë
Kullotë	km x	lekë =	lekë
Inproduktive etj	km x	lekë =	lekë.

Adresa: Lagjia Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 5; Tel+35581122288; E-mail: bashkiadevoll@gmail.com;
web:http://bashkiadevoll.gov.al/

c) Tarifa e shpërblimit të dëmit të shkaktuar në fondin pyjor/kullosor 69,000 leke .

1. Vlera e lëndës së punimit _____-_____ lekë.
2. Vlera e druve të zjarrit 12 mst* 600 leke/mst =6,000 lekë.
3. Vlera e prodhimeve të dyta pyjore _____-_____ lekë.
4. Kullotja 120 ha*5 krere/ha =600 : 600 krere *100/leke/krere=60,000 lekë.
5. Vlera e faunës 3000 lekë.
6. Vlera e investimeve të kryera (pyllëzime, zvëndësime, përmirësime, etj _-_ lekë.
7. Të tjera _____-_____ lekë.

PËRPILUSIT E RAPORTIT TEKNIKO-EKONOMIK

Specialist Ixhinier Pyjesh dhe Mjedisi


Orgest Cenolli

Antonio Kapshtica

Denis Xhuri

Drejtori Drejtorisë së Pyjeve
dhe Mjedisit
EDMIR CENOLLI

KRYETARI I BASHKISË
EDUARD DURO


39a
9a
138a
137
010
013
014
DEVOLL
138b
140a
015
17/a
009
017
016
008
019
05
Legjende
Zona e kerkuar per panele Fotovoltaike
Aux_data
Rendi_3_Kufi_bashki_VKM360
BaseLayers
Google Earth